



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.Dh.Sh.II.nr.1689/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Inspektorati i Punës, me seli në Prishtinë, kundër debitorit “26 Maji - Meha” SH.P.K, me seli në rr.“Kongresi i Manastirit” në fshatin Zllakuqan, në Lipjan, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.251/2023 të datës 21.07.2023, me datë 13.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET ankesa e debitorit “26 Maji - Meha” SH.P.K, me seli në rr.“Kongresi i Manastirit” në fshatin Zllakuqan, në Lipjan, PRISHET aktvendimi i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.251/2023 i datës 21.07.2023, dhe Lënda i kthehet të njëjtës gjykatë, në rivendosje dhe rigjykim.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.251/2023 të datës 21.07.2023, në pikën I të dispozitivit ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit “26 Maji - Meha” SH.P.K, të paraqitur kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.04/2023 të datës 19.01.2023, të lejuar nga përmbaruesi privat Arben Gashi. Në pikën II të dispozitivit ka lënë në fuqi urdhrin përmbarimor P.nr.04/2023 të datës 19.01.2023, të lejuar nga përmbaruesi privat Arben Gashi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës përmbarimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa, të ndryshohet aktvendimi i ankimuar apo i njëjtit të prishet dhe çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa e debitorit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Inspektorati i Punës, me seli në Prishtinë, me datë 16.01.2023 ka paraqitur propozim për përmbaerim kundër debitorit “26 Maji - Meha” SH.P.K, me seli në rr.“Kongresi i Manastirit” në fshatin Zllakuqan, në Lipjan, në bazë të dokumentit përmbaerues - Vendimit Nr.90/2018 të datës 24.12.2018, i formës së prerë nga data 20.04.2022 dhe i ekzekutueshëm nga data 20.04.2022.

Përmbaeruesi privat Arben Gashi, duke vepruar sipas propozimit për përmbaerim të kreditorit me urdhrin P.nr.04/2023 të datës 19.01.2023, ka lejuar përmbaerimin ndaj debitorit në bazë të dokumentit përmbaerues, duke vlerësuar se dokumenti përmbaerues i plotëson kushtet për përmbaerim. Kundër këtij urdhri përmbaerimor debitorit me datë 06.02.2023 ka paraqitur prapësim, duke e kundërshtuar urdhrin përmbaerimor, me arsyetimin se dokumenti mbi të cilin është nxjerrë ky urdhër nuk ka elemente të përmbaerueshmërisë, pasi që dokumenti në fjalë nuk përmban asnjë numër të vendimit mbi të cilin është bazuar i njëjti. Më tutje ka deklaruar se ndaj Vendimeve të kreditorit, debitorit ka inicuar konflikt administrativ duke ushtruar padi për anulimin e vendimeve të kreditorit. Andaj ka propozuar që të aprovohet në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit, të shfuqizohet urdhri për përmbaerim, ose të shtyhet përmbaerimit në këtë çështje përmbaerimore deri në vendosje të kësaj lënde në konfliktin administrativ.

Kreditori ka paraqitur përgjigjen në prapsim jashtë afatit ligjor

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.251/2023 të datës 21.07.2023, me të cilin në pikën I të dispozitivit ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit “26 Maji - Meha” SH.P.K, të paraqitur kundër Urdhrit Përmbaerimor P.nr.04/2023 të datës 19.01.2023, të lejuar nga përmbaeruesi privat Arben Gashi. Në pikën II të dispozitivit ka lënë në fuqi urdhrin përmbaerimor P.nr.04/2023 të datës 19.01.2023, të lejuar nga përmbaeruesi privat Arben Gashi, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar, për arsye se organi përmbaerues ka lejuar përmbaerimin në mbështetje të nenit 21 të LPP-së, se vendimi mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në kuptim të nenit 27 paragrafi 1 dhe 36 paragrafi 1 të LPP-së. Tutje gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se ka vlerësuar pretendimin e debitorit se lidhur me këtë çështje ka inicuar konflikt administrativ në gjykatë, mirëpo gjeti se vendimi Nr.90/2018 i datës 24.12.2018, përbën dokument përmbaerimor konform nenit 24 paragrafi 3 të LPP-së.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerësoj se aktvendimi i atakuar është i përfshirë me shkelje të dispozitave nga neni 182 par.2 pika (n) e LPK-së, sepse nuk ka dhënë arsyet për faktet vendimtare, lidhur me propozimin e debitorit në prapësimin e ushtruar me datë 06.02.2023, me të cilën debitori i propozon gjykatës së shkallës së parë, që në bazë të nenit 61 par.1 pika 1.1 e LPP-së, të bëj shtyrjen e përmbarimit në këtë çështje.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerësoi se gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e vendimit të atakuar në asnjë rast nuk ka përmendur apo trajtuar pretendimet e debitorit sa i përket propozimit për shtyrje të përmbarimit konform nenit 61 të LPP-së, porse i gjithë arsyetimi i aktvendimit të atakuar ka të bëjë me prapësimin e debitorit kundër Urdhrit përmbarimor P.nr.04/2023 dt.19.01.2023 i lejuar nga përmbaruesi privat Arben Gashi.

Dhomat e shkallës së dytë, vlerësoi se në kuptim të nenit 182 par.2 pika (n) të LPK-së, është kontradiktor dispozitiv i aktvendimit ankimor me arsyetimin e tij, sepse në dispozitiv dhe arsyetim të aktvendimit të atakuar, në asnjë rast nuk jepen shpjegime ligjore dhe faktike, lidhur me propozimin e debitorit për shtyrjen e përmbarimit, përderisa në dispozitiv të aktvendimit gjykata refuzon në tërsi prapësimin e debitorit i ushtruar kundër urdhrit përmbarimor P.nr.04/2023 dt.19.01.2023 i lejuar nga përmbaruesi privat Arben Gashi.

Shkeljet e tilla respektivisht kontradiktat si në arsyetimin e aktvendimit të atakuar përfaqësojnë shkelje thelbësore të dispozitave ligjore, që kanë pasur ndikim në marrjen e aktvendimit të ligjshëm dhe të drejtë andaj aktvendimi i atakuar doemos është dashur të prishet.

Në riprocedurë, Dhomat e Shkallës së parë, me rastin e rivendosjes dhe rigjyqimit të kësaj çështje, të shqyrtoj në baza ligjore propozimin e debitorit për shtyrjen e përmbarimit në vështrim të nenit 61 të LPP-së, gjithashtu të vendos edhe për pretendimet e tjera të debitorit të parashtruara në prapësimin e datës 06.02.2023 ndaj urdhrit përmbarimor P.nr.04/2023 i datës 19.01.2023 i lejuar nga përmbaruesi privat Arben Gashi.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika d), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS  
Dhomat e Shkallës së Dytë  
K.Dh.Sh.II.nr.1689/2023 me datë 13.05.2024

Gjyqtari,  
Krenar Berisha